

VENDIM
Nr. 190, datë 12.8.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “d”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/15 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 3.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në median e shkruar më datat 4.6.2025 dhe 5.6.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve (deri më 13.6.2025), nuk u paraqit asnjë koment.

- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 5.6.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Kjo shkresë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj më 11.6.2025 iu dërgua shoqërisë nëpërmjet e-mail-it një kopje e skanuar.

- Në përgjigje, me e-mail-in e datës 20.6.2025, shoqëria depozitoi pjesërisht dokumentacionin e munguar, duke njoftuar se vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin do ta sillte sapo të pajisej me të dhe të përkthehej. Po atë ditë, ky dokumentacion u depozitua edhe fizikisht në protokollin e ERE-s me nr. 1693/9 prot., datë 20.6.2025.

- Për sa më sipër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 7.7.2025, është vendosur zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s deri në 30 (tridhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 20 (njëzet) ditëve të depozitojë në ERE vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, me shkresën nr. 1693/11 prot., datë 9.7.2025, shkresë, e cila është kthyer sërish mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj i është dërguar shoqërisë një kopje e skanuar me e-mail-in e datës 15.7.2025.

- Me e-mail-in e datës 16.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/12 prot., datë 16.7.2025, shoqëria ka përditësuar adresën e saj dhe ka njoftuar për të depozituar brenda afatit dokumentin e munguar.

- Me e-mail-in e datës 28.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/13 prot., datë 28.7.2025, dhe së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1691/14 prot., datë 4.8.2025, shoqëria ka depozituar në ERE-dëshminë e penalitetit të administratorit në format original.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germet “a”, “b” dhe “c”; pikën 1.2, germet “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3, germet “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

- Vlefshmëria kontratave të shërbimit për stafin teknik (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit) nuk mbulon të gjithë afatën 5-vjeçar të licencës, ndaj brenda afatit të përfundimit të tyre, pra brenda datës 1.2.2026 shoqëria duhet që të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të zbatuar në vijim edhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Brenda datës 1.2.2026, shoqëria duhet të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në lidhje me plotësimin/mosplotësimin e pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petra Lika